


# UDHA ISLAMIE

Viti XII - Nr. 2 (132), Shkurt, 2014

Organ i Myftinisë Shkodër

E përmuajshme Informativ-Fetare-Kulturore-Edukative

## MUSLIMANËT, EDUKATORËT E EUROPËS





**Imam Muhamed B. Sytari**  
Myfti i Zonës Shkodër

**E**dukata e dijes dhe e kulturës në Islam, nis me ajetin e parë të sures El-Alak: “*Lexo me emrin e Zotit tënd që krijoi*”.<sup>1</sup> Ky ajet në vetëvete e madhëroi vërtetësinë e leximit dhe të dijes, sikurse lajmëroi se në Islam mendimi dhe mendja kanë një vend në pedestal, por njëkohësisht hapi thelbin e qytetërimit islam para mbarë botës.<sup>2</sup>

Më pas urdhëroi: “*Thuaj: A janë të barabartë ata që dijnë dhe ata që nuk dijnë?*”<sup>3</sup>, që u pasua me ajetin: “*Dhe thuaj: Zoti im, ma shto mua diturinë!*”<sup>4</sup>, si dhe me ajetin e parë të sures El-Kalem: “*Nún - Pasha lapsin dhe atë çfarë shkruhet*”.<sup>5</sup>

Pra, në një mënyrë a një tjetër, Islami erdhi me shpirtin dhe frymën e dijes. Ai edukoi ditë pas dite ndjekjen e rrugëve të saj, specializimin në dituri të ndryshme, analizimin dhe thellimin në të mirë dhe në dobi të njerëzimit.

Por, mbi të gjitha nxiti edukimin e mendjes dhe zemrës, që në moshë të vogël, në rrugën e edukimit të një individi të shëndoshë musliman, i aftë për t’u përballur me jetën, për ta ndërtuar më pas, në rrugën e trashëgimit të mirësive të Zotit, brez pas brezi.

Nga ana tjetër, Resulull-llahu (a.s) u bë nxitësi shembullor i kërkimit

1. Kur’ani, El-Alak: 1, nga pesë ajetet e para që zbritën fillimisht nga krejt Kur’ani.

2. Abdullah Nasih Ulvan, “Terbijatul-euladi fil-Islam”, botimi 30, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 196.

3. Kur’ani, Ez-Zummer: 9.

4. Kur’ani, TaHa: 114.

5. Kur’ani, El-Kalem: 1.

## MUSLIMANËT, EDUKATORËT E EUROPËS, DRITËSUESIT E SAJ

të dijes dhe lartësimit të pozitive të dijetarëve, deri aty sa ia obligoi kërkimin e dijes të gjithë muslimanëve.

Njëkohësisht, Hz. Muhammedi (a.s) shpjegoi rëndësinë dhe madhëstinë e këtij obligimi, kur tha: “*Me të vërtetë All-llahu, melekët e Tij, banorët e qiellit dhe të tokës, deri buburreca në vrimën e saj, edhe balena, kërkojnë falje për atë që u mëson njerëzve të mirën*”.<sup>6</sup>

Madje, në hadithin e transmetuar nga Imam Muslimi, në lidhje me fisnikërinë e atij që del për të kërkuar dituri, pra për studentin që e ka një nijet të pastër për të mësuar e për t’u bërë një specialist a dijetar i dobi-shëm për vendin dhe fenë e tij, tha: “*Dhe ai që ndjek një rrugë, në të cilën kërkon dituri, All-llahu do t’ia lehtësojë rrugën për në xhennet*”.<sup>7</sup>

Nga këtu, ata që analizuan rezultatet e kësaj nxitje dhe këtij shpirti të pashembullt në histori, konkluduan se ishte pikërisht Islami ai që udhëhoqi njerëzimin me dritën e dijes, deri në atë gradë, sa diferencat në mesin e muslimanëve të ditur dhe jomuslimanëve analfabetë ishin shpeshherë shokuese.

Dhe shembulli më i mirë, janë shekujt dritësues të Islamit në Evropën analfabete, plot injorancë dhe të zhytur në mjerim. Dijetarë të ndryshëm, muslimanë dhe jo, kanë hedhur dritë me objektivizëm mbi fakte të shumta, që vërtetojnë dhe dëshmojnë mirësinë e madhe që bënë mësimet e Islamit, që nga momenti i parë i depërtimit në Evropë.

Si të thuash, teksa muslimanët hapnin errësirat e kontinentit të vje-

tër, me dritën e Kur’anit dhe Traditat e Hz. Muhammedit (a.s), një shpirt i ri përparimtar dhe një qytetërim i ri hyjnor, bëhej gati të begatonte qiellin dhe tokën e Andaluzisë evropiane, që dëshmonte All-llahun, Zot të Vetëm të gjithësisë dhe, Muhammedin (a.s), si Vulë të profetëve të Zotit.

**Dr. Abdurrahman Ali El-Haxhi**, pedagog i historisë islame, në Fakultetin e Letërsisë, në Universitetin e Kuvajtit, teksa shkruan për zhvillimin e Andaluzisë nën dejtimin e muslimanëve, përmend se në vitin 719: “*Nisën të ndërtoheshin disa godina të reja. Fillimisht u ngritën xhamitë, në vende të ndryshme - kjo ishte vepra e parë që ndërtonin muslimanët kudo, kur banoni një vend - poashtu medresetë (shkollat)... Përherë në botën islame, xhamitë njiheshin edhe si institute për të mësuar njerëzit*”.<sup>8</sup>

Ndërsa, teksa flet për respektimin e treguar nga muslimanët në Spanjë ndaj objekteve të kultit joislam, argumenton: “*I shihje xhamitë përbri kishave, ato asnjëherë nuk u kthyen në xhami, vetëm se në rastet e konvertimit të tyre a braktisjes, pasi njerëzit përqafojnë Islamin*”.<sup>9</sup>

Ai, gjithashtu konstaton se: “*Si rezultat i mirësjelljes islame, u shtuan edhe rastet e lidhjeve dhe përzierjes së muslimanëve me jomuslimanët e Spanjës, deri aty sa në disa raste ndodhen edhe lidhje martesore*”.<sup>10</sup>

Studiuesi **Christie Arnold**, në librin e tij “Trashëgimia islame në art, fotografi dhe arkitekturë”, ndër të tjera pohon se: “*Për rreth një mijë vjet, Europa qëndroi si e shastisur për-*

8. Dr. Abdurrahman Ali El-Haxhi, “Et-Tarikhul-Endelusi”, botimi i VII-të, Damask, 2010, fq. 148.

9. Po aty, fq. 165.

10. Po aty, fq. 165.

ballë artit islam”.<sup>11</sup>

Ndërkohë, orientalisti hollandez **Reinhardt Dozy** (1820-1883), pedagog i gjuhës arabe në Universitetin e Lidenit, shkruan: “Në të gjithë Andaluzinë nuk gjendej një analfabet, ndërkohë që shkrim e këndim në mënyrë parësore, në të gjithë Europën, nuk dinte vetëm se klasa e lartë e priftërinjve”.<sup>12</sup>

Orientalisti anglez **Stanley Lane-Poole** (1854-1931), pedagog i studimeve arabe në Universitetin e Dublinit, në librin e tij: “Arabët dhe Spanja”, shkruan: “Ndërkohë që Europa analfabete zhytej në injorancë dhe mjerim, Andaluzia udhëhiqte dhe mbante flamurin në dije dhe kulturë”.<sup>13</sup>

Poeti libanez **Iljas Ebu Shabaka** (1903-1947), në librin e tij: “Lidhjet e mendimit dhe shpirtërores në mesin e arabëve dhe francezëve”, shkruan se: “Perëndimi i civilizimit arab, ishte një mjerim i madh për Spanjën dhe Europën, pasi Andaluzia nuk e njohu mirëqenien vetëm se nën hijen e arabëve. Sapo arabët ikën, aty mbizotëroi shkatërrimi në vend të pasurive, bukurisë dhe gjelbërimit...”.<sup>14</sup>

Ndërsa mjeku dhe fizikanti ukraino-amerikan, **Victor Robinson** (1886-1947), teksa shkruan për civilizimin arabo-islam në Andaluzi, konstaton se: “... Paskanikët e Europës nuk arrinin dot të firmosnin emrat e tyre, ndërkohë që fëmijët e muslimanëve në Kordova shkonin nëpër medrese. Ndërsa murgjërit belbëzonin në leximin e teksteve të shenjta në kisha, mësuesit e Kordovës kishin themeluar një bibliotekë, që krahasohej për nga madhështia me bibliotekën Aleksandrisë...”.<sup>15</sup>

Ateisti **George Bernard Shaw** (1856-1950), irlandezi nobelist, dramaturg dhe kritik i letërsisë dhe i muzikës, tha shprehjen e tij të madhe, në të cilën konstatoi se: “Feja e Muham-



medit ishte argument vlerësimi të lartë... Ajo ishte feja e vetme që kishte aftësi të përfshinte të gjitha fazat e jetës. Unë mendoj se është detyrim për ne ta konsiderojmë Muhammedin si shpëtimtarin e njerëzimit! Dhe se një person në performancën e tij, nëse do të kishte në dorë fatet e botës së re, do të arrinte sukses në zgjidhjen e problemeve të saj”.<sup>16</sup>

Ndërsa dekani i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Vjenës, shkencëtari **Sherbel**, në Kongresin e Drejtësisë, në vitin 1927, konstaton botërisht se: “Njerëzimi duhet të ndjehet krenar me aderimin në të, të një burri si Muhammedi (a.s), i cili, me gjithë analfabetizmin e tij, para rreth 13 shekujsh, arriti të sillte një legjislacion, që do të na bënte ne evropianëve më të lumturit e botës, nëse do të arrinim në thelbin e tij, pas dymijë vjetësh!”.<sup>17</sup>

Këto dëshmi dhe shumë të tjera (pa fund), arrijnë në këto konkluzione,

sepse në Islam: “Kërkimi i diturisë është obligim për çdo musliman”<sup>18</sup>, mashkull a femër qoftë, por edhe për faktin se muslimanët u edukuan që dijen ta përhapin, mos ta fshehin në asnjë mënyrë.

Resulull-llahu (a.s), ishte i prerë kur tha: “Ai që fsheh një dije, me të cilën All-llahu i sjell dobi njerëzve në çështjet e fesë, All-llahu do ta ndëshkojë me zjarr në ditën e gjykimit”!<sup>19</sup> Dhe në Islam, kur bëhet fjalë për fenë, në fakt bëhet fjalë për krejt jetën dhe çfarë e bën njeriun të jetojë me dinjitet, sipas hartës së shënuar nga Zoti i gjithësisë...

Shkodër, më 21 shkurt 2014

(Hytbeja e xhumasë,  
mbajtur, më 21. 2. 2014,  
në xhaminë e Parrucës)

11. Abdullah Nasih Ulvan, "Terbijetul-euladi fil-Islam", botimi 30, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 197.

12. Po aty, fq. 197.

13. Po aty, fq. 197.

14. Po aty, fq. 197.

15. Po aty, fq. 197.

16. Po aty, fq. 197.

17. Po aty, fq. 197.

18. Transmetuar nga Ibni Maxheh, nga Enesi (r.a).

19. Transmetuar nga Ibni Maxheh, nga Ebu Said El-Khudri (r.a).

# TEVESSULI - TË AFRUARIT ME ALLAHUN (XH.SH)

## PËRMES PEJGAMBERIT (A.S) DHE NJERËZVE TË MIRË SALIHINË

FETVA E ZYRËS SË FETVAVE, EGJIPT

**T**ë afruarit me Allahun (xh.sh), tevesulli përmes Pejgamberit (a.s) është një çështje që për të kanë rënë në konsensus imamët e të katër medhhebeve, por megjithatë ka disa njerëz që blasfemojnë (qafirizojnë) këdo që bën afrimitet (tevesull) përmes Pejgamberit (a.s) dhe njerëzve të mirë salihinë.

Ndonjëherë një vepër të kryer ia atribuojmë vepruesit të saj, p.sh filani ka vepruar kështu dhe, ndonjëherë atë vepër ia atribuojmë Krijuesit si, p.sh Allahu (xh.sh) veproi kështu. Sipas gjuhës arabe të gjitha janë të vërteta, sepse në Kur'anin famë-lartë ka ardhur ajeti: **"Allahu udhëzon kë dëshiron në rrugën e drejtë"** - (Bekare: 213), **"Kë udhëzon Allahu, ai është i udhëzuar"** (Kehëf: 17), por megjithatë Allahu (xh.sh) ka thënë: **"Me të vërtetë (o Muhamed) ti udhëzon në rrugën e drejtë"** - (Shura: 52) e kjo është shumë e njohur.

Prandaj, nëse disa njerëz mohojnë atribuimin e veprave vepruesve të tyre, ata njerëz janë që nuk mendojnë edhe po qe se pretendojnë se realiteti i fjalëve të njerëzve qëndron në atribuimin e veprave Krijuesit dhe jo vepruesit të tyre. Ky është një pretendim i rremë për të cilin nuk ekziston asnjë argument dhe me këtë gjë disa njerëz kanë lejuar të derdhet gjaku i myslimanëve me injorancë dhe dalalet (humbje). Kushdo që ndalon atribuimin sipas veprimit, të ndërpriten fjalët dhe biseda me të.

P.sh: Bereqeti (shiu) është krijim

dhe ekzistencë prej Allahut (xh.sh), ndërsa prej Pejgamberit (a.s) është shkak (sebepe) dhe përfundim. Kjo, në qoftë se ne supozojmë se kërkojmë nga Pejgamberi (a.s) të na sjellë bereqet (shiu), megjithëse ne nuk e kemi bërë këtë gjë, por edhe sikur ta bënim kjo gjë do të ishte e saktë, sipas idesë së shkakut (sebepe) dhe veprimit duke i kërkuar Pejgamberit (a.s) të na bëjë dua. Nëna e Ismailit

të shkatërrohet pasuria e tyre për shkak të tevesullit dhe kërkimit të ndihmës që bëjnë?! Duke ditur se në hadithin e saktë ka ardhur: "Kushdo që i thotë vëllait të tij "o qafir", njëri prej tyre e ka merituar: Ose është për të cilin e ka thënë, ose i kthehet akuzuesit" (transmeton: Muslimi). Dhe Allahu (xh.sh) thotë në Kur'an: **"Dhe mos i thoni, atij që ju jep selam, nuk je besimtar (!) duke kërkuar pasurinë e jetës së dynjasë"**. Në qoftë se kjo vlen për një njeri, i cili nuk zotëron tjetër, veçse një selam që është përshëndetja e myslimanit, atëherë çfarë mund të themi për atë njeri që guxon ndaj më të zgjedhurit të ymetit muhamedan, i blasfemon (qafirizon) për shkak të tevesullit me pejgamberë dhe salihin (njerëz të mirë) me dyshim, i cili është më i dobët se rrjeta e merimangës? Kur dihet se: Bindshmëria nuk largohet me dyshim dhe se myslimani justifikohet deri në 70 arsye, ashtu siç ka thënë edhe imam Neveviu e të tjerë dijetarë.

Këta njerëz, a i marrin shprehjet bllof (sipërfaqësisht), apo sipas kuptimit (qëllimit) të tyre? Nëse besimi për ta është sipas kuptimit bllof (sipërfaqësor), atëherë thënia e dikujt: "Pranvera na solli gjelbërimin", "uji ma shoi etjen", "buka më ngopi" ... është shirk dhe kufr (blasfemi). Por, në qoftë se të nxënit është sipas qëllimit dhe besimi sipas asaj që ka në zemër, e cila beson se nuk ka krijues tjetër, përveç Allahut dhe se atribuimi dikujt tjetër është thjesht vepruesi dhe shkak për të, e jo krijuesi; të

(a.s), sipas transmetimit të Buhariut, kur dëgjoi zhurmën tha: "Na furnizo (na lësho shiu), nëse ke furnizim", duke ia atribuuar furnizimin (zhurmës), thjesht si shkak (sebepe).

Atëherë pra, si lejohet pas gjithë kësaj të blasfemohen (qafirizohen) myslimanët e të derdhet gjaku e



gjitha këto nuk kanë të bëjnë aspak me blasfeminë (kufrin) dhe me shirkun. Por, njerëz të tillë, sipas asaj që thonë gabojnë, veçanërisht në dallimin mes të gjallit dhe të vdekurit, sikur i gjalli vlen të jetë ortak (shirik) dhe i vdekuri jo. Apo, sikur shpirtrat e marrin fuqinë dhe pushtetin nga fantazmat, e jo e kundërta.

Ibn Kajimi, në librin e tij "Shpirti" ka thënë: Shpirti i liruar nga prangat e trupit, vargonjtë e tij, pengesat në veprim e ekzekutim, vrulli, shpejtësia e ngjitjes tek Allahu (xh. sh) dhe ngjizja për Të; nuk i ngjason shpirtit të nënshtruar e të burgosur në vargonjtë e trupit, për shkak të zhytjes së tij në epshe. Në qoftë se kjo ndodh në natyrën e jetës tokësore që është e burgosur në trupin e tij, atëherë çfarë mund të themi kur ai të zhvishet e të ndahet prej tij e të bashkojë fuqitë që ka; kur në origjinë ka qenë shpirt i lartë, i pastër e i madh me vullnet të lartë?! Prandaj, ky pas ndarjes prej trupit është çështje dhe punë tjetër. Janë transmetuar shumë pamje (ëndrra) të shpirtrave të njerëzve pas vdekjes së tyre duke bërë vepra që nuk mund të llogariten, në gjendje kur ata ishin në trup. Si, disfata ushtrish të mëdha nga një person i vetëm, apo humbje taborresh të mëdha ushtrish prej një numri të vogël etj. Është parë (në ëndërr) Pejgamberi (a.s) e së bashku me të, Ebu Bekri dhe Umeri (r.a) ku shpirtrat e tyre kanë mposhtur ushtritë e femohimit e të zullumit, duke pësuar disfatë edhe pse në numër kanë qenë të shumtë, ndërsa besimtarët në numër të vogël. Kështu thotë Ibn Kajimi.

Ndërsa Sheukani ka thënë: Shejkhul-Islami Ibn Tejmije ka thënë në disa fetva të tija: "Istigathja (kërkimi ndihmë) me kuptim që të kërkosh prej Pejgamberit (a.s) atë që e meriton pozita dhe grada e tij,

për këtë nuk ka kundërshtim prej asnjë myslimani, por ai që e kundërshton këtë kuptim, ose është mohues (qafir), ose gabimtar i humbur". Dhe, Sheukani thotë: Shefaati përmes një krijese nuk ka kundërshti mes asnjë myslimani, pra lejohet shefaati përmes krijesave prej asaj që ata kanë mundësi nga çështjet e kësaj bote.

Pastaj Sheukani vazhdon: Në Sunenin e Ebu Davudit transmetohet se një njeri i tha Pejgamberit (a.s): Ne



kërkojmë shefaat me ty tek Allahu dhe kërkojmë shefaat me Allahun tek ty. Pejgamberi (a.s) i tha: "Nuk bëhet shefaat me Allahun tek asnjë prej krijesave të Tij. Çështja e Allahut është shumë më e madhe se kaq". Pra, e miratoi thënien "bëjmë shefaat me ty tek Allahu" dhe Sheukani vazhdon përsëri duke thënë: Ndërsa tevessuli (afrimiteti) tek Allahu (xh.sh) me ndonjë prej krijesave të Tij për diçka që robi ia kërkon Zotit të tij, Shejkh Izudin ibn Abduselam

ka thënë: "Nuk lejohet tevessuli (afrimiteti) tek Allahu, përveç se me Pejgamberin (a.s), nëse hadithi për këtë është i saktë". Ndoshta ai tregon për hadithin, të cilin e transmeton Nesaiu, Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe të tjerë: "Një njeri i verbër erdhi te Pejgamberi (a.s) dhe i tha: O i Dërguar i Allahut, më janë verbuar sytë, prandaj lute Allahun për mua. Pejgamberi (a.s) i tha: "Merr abdes dhe fal dy rekatë, pastaj thuaj: **O Allah, unë të lutem Ty dhe po të drejtohem Ty me të Dërguarin tënd, Muhammedin; o Muhammed unë po bëj shefaat me ty për të mu kthyer shikimi im. O Allah, ma bëj shefaat Pejgamberin për mua. Ai (a.s) i tha përsëri: Nëse ke ndonjë nevojë tjetër, vepro kështu përsëri".** Allahu ia ktheu shikimin e tij.

Pastaj Sheukani thotë: Unë mendoj se nuk ka vend për të specifikuar lejimin e tevessulit vetëm me Pejgamberin (a.s), ashtu siç pretendon shejkh Izudin ibn Abduselam, dhe kjo për dy arsye:

**E para:** Prej asaj që njohim nga konsensusi i sahabeve (r.anhum).

**E dyta:** Tevessuli tek Allahu me njerëzit e mirë dhe të dijes, në të vërtetë, është tevessul me veprat e tyre të mira dhe cilësitë e larta që ata kanë. Sepse, i miri nuk është i mirë, vetëm se me veprat e tij. Prandaj, nëse dikush thotë: O Allah, unë po të afrohem (po bëj tevessul) te Ty me filan dijetar, ai ka për qëllim diturinë e tij që ka arritur. Kjo është vërtetuar në dy librat e Saktë dhe të tjerë se, Pejgamberi (a.s) tregoi për tre persona, të cilët hynë në një shpellë dhe atyre iu mbyll dera me një shkëmb. Secili prej tyre bëri tevessul tek Allahu me punën më të mirë që kishte bërë në jetën e tij dhe shkëmbi u largua (u lirua hyrja e shpellës). Prandaj, sikur tevessuli me vepra e mira të mos ishte i lejuar, apo të ishte shirk siç pretendojnë

disa vështirësues të kësaj çështje, si Ibn Abduselam dhe të tjerë pasues të tij që e kanë mbështetur, nuk do të vinte përgjigjja nga Allahu (xh.sh) dhe as nuk do të heshte i Dërguari i Allahut (a.s) për të mohuar veprimin të tyre, pasi e tregoi atë.

Pastaj Sheukani thotë: Dhe me këtë, dije se ato ajete që sjellin ndaluesit e tevellulit tek Allahu përmes Pejgamberëve dhe njerëzve të mirë, si ajeti: **"Ne nuk i adhurojmë ata, veçse për të na afruar pranë tek Allahu"** (Zumer: 3), **"Mos lut me Allahun askënd tjetër"** (Xhin: 18), **"Ai e meriton lutjen, ndërsa ata të cilin lusin dikën tjetër, përveç Tij ata nuk u përgjigjen për asnjë gjë"** (Rad: 14) nuk janë argumente pro, madje këto tregojnë se ata janë larg të kuptuarit, sepse ajeti: **"Ne nuk i adhurojmë ata, veçse për të na afruar pranë tek Allahu"**, bën fjalë për adhurim, ndërsa tevelluli me anë të dijetarit, ai nuk adhurohet, por mbase ai ka cilësi dhe gradë të lartë tek Allahu, duke qenë mbartës i dijes, për këtë gjë bëjmë tevellul me të. Gjithashtu edhe ajeti: **"Mos lut me Allahun askënd tjetër"** është ndalim të lutet dikush tjetër me Allahun, sikur dikush të thotë: O Allah, o filani. Ndërsa tevelluli me dijetarin, p.sh nuk ka lutur, vetëm se Allahun, por ka ndodhur tevelluli prej tij me një punë të mirë që robërit e Tij kanë vepruar, ashtu siç vepruan tre personat, të cilët hynë në shpellë dhe shkëmbi blloko i hyrjen e saj dhe u lutën me veprat e tyre të mira.

Gjithashtu edhe ajeti: **"Lusin dikë tjetër, përveç Tij"** këta njerëz kanë lutur dikën që nuk u përgjigjet e nuk kanë lutur Zotin e tyre, i Cili iu përgjigjet. Kështu që, tevelluli me dijetarin, p.sh nuk është lutur, veçse Allahu, nuk është lutur dikush tjetër, përveç Tij dhe nuk është lutur askush tjetër me Të. Në qoftë se këtë e kupton, atëherë nuk mund të të fshihet se refuzimi i argumenteve që ndaluesit sjellin për tevellulin, janë jashtë



kontekstit. Pastaj vazhdon e thotë: Kërkuesi i tevellulit me cilindo prej Pejgamberëve, apo dijetarëve nuk e mendon (beson) se personi me të cilin ka bërë tevellul është ortak me Allahun në asgjë. Kush e beson këtë gjë për cilindo njeri qoftë, pejgamber, apo jo, atëherë ai është në humbje të qartë.

Edhe argumentimi i tyre në ndalimin e tevellulit me ajetin: **"Ti nuk ke asgjë (në dorë) për këtë çështje"** (Ali Imran: 128), **"Thuaj: Unë nuk posedoj asnjë dobi, apo dëm për vete"** (Earafë: 188), këto dy ajete sqarojnë se Pejgamberi (a.s) nuk ka asgjë në dorë prej çështjeve të Allahut (xh.

sh) dhe se ai (a.s) nuk posedon asnjë dobi, apo dëm për veten e tij, e si atëherë të posedojë për dikën tjetër. Në to nuk ka ndalim për tevellul me Pejgamberin (a.s), apo me dikën tjetër prej Pejgamberëve, evliave dhe dijetarëve. Me të vërtetë Allahu (xh.sh) i ka dhënë të Dërguarit të Tij (a.s) një pozitë të lavdishme, pozitën e shefaatit (ndërmjetësimit) të madh dhe i ka orientuar krijesat e Tij që t'ia kërkojnë Atij këtë gjë dhe të lutën për të: **"Lutu, e të jepet dhe ndërmjetëso (bë shefaat) e të pranohet ndërmjetësimi"** - (Transmeton Buhariu).

Kështu është edhe argumentimi, për ndalimin e tevellulit, me hadithin e Pejgamberit (a.s) kur zbriti ajeti: **"Tërhiqja vëmendjen njerëzve tuaj të afërm"** - (Shuara: 214): "O Abas ibn Abdulmutalib, nuk mund të të bëj asnjë dobi tek Allahu. O Safije, halla e Resulullahit, unë nuk mund të të bëj asnjë dobi për ty tek Allahu" (transmeton Buhariu). Në këtë hadith nuk ka sqarim tjetër, vetëm se për të treguar që Pejgamberi (a.s) nuk mundet t'i bëjë dobi atij që Allahu dëshiron t'i bëjë dëm dhe nuk mundet t'i bëjë dëm atij që Allahu dëshiron t'i bëjë dobi. Dhe se ai (a.s) nuk posedon për njerëzi e tij të afërm, pa le pastaj për ata të largët, asgjë që ka Allahu (xh.sh). Kjo është e qartë dhe e ditur për çdo mysliman dhe nuk tregon se nuk duhet të bëhet tevellul me të (a.s) tek Allahu. Sepse kjo është kërkesë për dikën që ka diçka në dorë dhe se, kërkuesi ka dëshirë që të paraqesë, së bashku me kërkesën e tij diçka që është shkak për një përgjigje prej Atij që është i Vetëm në dhënie dhe ndalim. Këtu përfundon edhe shpjegimi i Sheukanit.

Pas gjithë kësaj, Ibn Kudame El-Hanbeliu në librin e tij "El-Mugni", i cili është edhe prej librave më të vlefshëm të Hanbelive, ose më mirë të themi, absolutisht libri më i vlefshëm i tyre, duke përshkruar më-

nyrën e të vizituarit të Pejgamberit (a.s) thotë: *Afrohesh te varri i tij, i sjell shpinën kibles, qëndron në qendër të varrit dhe thuaj: Es-selamu alejke ve rahmetullahi ve berekatuhu, o i Dërguar i Allahut, o Pejgamber i Tij dhe më i zgjedhuri i krijesave të Tij. ... O Zoti im, shpërbleje për ne të Dërguarin tonë me shpërblimin më të mirë që ke shpërblyer ndonjë prej Pejgamberëve dhe të Dërguarve të Tu. Ringjalle atë në pozitën e lavdishme, të cilën ia ke premtuar, pozitë që e ka zili çdo krijesë e Jotja... O Zoti im, Ti ke thënë fjalën e vërtetë: **"Dhe sikur ata, kur i bënë zullum vetes së tyre, të vinin tek ti, t'i kërkonin falje Allahut dhe të kërkonte falje për ta i Dërguari, do ta gjenin Allahun Pranues i pendimit e Mëshirues"** - (Nisa: 64), prandaj edhe unë kam ardhur tek ti duke kërkuar falje për gjynahet e mia dhe duke të të kërkuar shefaat me ty tek Zoti im", përfundon citimi prej Ibn Kudames.*

Nuk ka shkuar larg kërkimi i faljes (istigfari) i tij për ne edhe pas ndërrimi jetë të tij (a.s), sepse është transmetuar në hadithin e saktë: "Veprat tuaja më paraqiten mua dhe kur shoh të mira, falënderoj Allahun për ta, ndërsa kur shoh të këqija i kërkoj falje (istigfar) Allahut për ju" (transmeton Bezari). Për saktësinë e këtij hadithi ka folur gjatë El-Menavi dhe të tjerë. Kështu që e shikon vetë se si vërtetohet kërkimi i faljes (istigfari) i tij për ne me hadith, edhe pas ndërrimit jetë të tij (a.s).

Këto janë fjalët e Hanbelive të parë, pasuesit e medhhebit të Imam Ahmedit, të kapurit pas sunetit të Pejgamberit (a.s) dhe dashurisë për të, si gjithë dijetarët e medhhebeve të tjera.

Tevesulli përmes Pejgamberit (a.s) është konfirmuar para dhe pas ekzistencës së tij në këtë botë, pas vdekjes së tij gjatë periudhës së berzahit (jetës së varrit) dhe pas ringjalljes në gjendjen e Ditës së Kiametit.

Sa i përket tevesullit me të (a.s) përpara se të ekzistonte e tregon transmetimi i Hakimit në librit e Saktë të tij, që Dhehebiu nuk e ka gjurmuar në librin, në të cilin ka gjurmuar Hakimin për librin Mustedrek të tij, por këtë transmetim e ka saktësuar edhe Maliku, siç transmeton Kadi Ijad në "Esh-Shifa" se: "Ademi (a.s) kur bëri gabimin, bëri tevesull tek Allahu përmes Muhammedit (a.s), ku Allahu (xh.sh) i tha: "Nga e njohe Muhammedin, ndërkohë Unë akoma nuk e kam krijuar? Ademi (a.s) tha: E gjeta emrin e tij të shkruar pranë emrit Tënd dhe e kuptova se ai është krijesa më e dashur



për Ty. Atëherë Allahu (xh.sh) i tha: "Me të vërtetë ai është krijesa më e dashur për Mua dhe për këtë shkak, se më bëre tevesull me të, patjetër që të kam falur".

Maliku i është përgjigjur Mensurit, kur ky i fundit e pyeti: O Ebu Abdullah, a të kthehem nga kibla e të lutem, apo të kthehem nga Pejgamberi (a.s)? – "Po, përse do t'ia kthesh shpinën, ndërkohë që ai është lidhja (vesilja) jote tek Allahu dhe lidhja (vesilja) e babait tënd, Ademit", duke bërë me shenjë nga hadithi i mësipërm.

Ndërsa, komentuesit e Kur'anit kanë thënë për ajetin: **"Dhe më përpara kërkonin ndihmë kundër atyre që nuk kanë besuar"** - (Bekare: 89), fisi hebre Kurajdha dhe Nadir kur luftonin ndaj idhujtarëve arab i kërkonin ndihmë Zotit duke ndërmjetësuar me Pejgamberin e fundit që do të dërgohej në ahirzaman, e ata fitonin kundër tyre. Pra, siç e shikon, ata i janë lutur Allahut me të (a.s) përpara ekzistimit të tij.

Sikur të vazhdonim të sillnim argumente rreth lejimit të tevesullit (af- rimitetit) me Pejgamberin (a.s) do të zgjateshim shumë, prandaj këto që sollëm janë të mjaftueshme **"për atë që ka zemër, apo dëgjon me vëmendje dhe është dëshmitar"** - (Kaf: 37).

Nga sa thamë më sipër, shihet qartë se tevesulli me njerëz të mirë, evlia dhe dijetarë nuk del jashtë asaj që përmendëm dhe kuptimit të fshehtë të saj. Kush dëshiron, ecë në këtë rrugë dhe e ndjek këtë shkak (sebe), por nëse refuzon, atëherë të paktën të mos i bëj keq njerëzve, e të ndalohet të bërit keq myslimanëve, me fjalë dhe me dyshimet e tij.

Me të vërtetë, Allahu i Lartëmadhëruar e di më së miri.

*Përktheu nga arabishtja:*  
**Lavdrim Hamja**

## MYFTIU I GOSTIVARIT VIZITON MYFTININË SHKODËR



**D**itën e shtunë, më 25 janar 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari ka pritur në një takim të përzemërt vëllazëror, Myftiu e Gostivarit, Shaqir ef. Fetahu me bashkëpunëtorët e tij.

Gjatë takimit, Myftiu i Shkodrës ka shprehur kënaqësinë e madhe me rastin e vizitë së Myftiut të Gostivarit, Shaqir ef. Fetahu, një ndër personalitetet më të shquara islame shqiptare në trojet tona në Republikën e Maqedonisë.

Gjithashtu, ka ndarë me mikun e tij disa nga kujtimet e bukura të vizitës së tij në Gostivar, para një muaji, me ftesë të Forumit të Rinjve Muslimanë të Gostivarit, ku së bashku ndanë emocionet e një mbrëmje fetare të mrekullueshme.

Ndërkohë, Myftiu i Gostivarit, ka falënderuar homologun e tij për mikpritjen dhe frymën e bashkëpunimit dhe vëllazërisë islame, që ka ndikuar në afrimin e mëtejshëm të dy myftinive përkatëse dhe mundësinë e bashkëpunimeve konkrete, me aktivitete të përbashkëta, këshillime, këmbime përvoja, vizita të ndryshme etj.

Gjatë kësaj vizite, të dy myftilerët kanë këmbyer mendime dhe vështrime rreth realitetit të Thirrjes Islame në trojet tona dhe mëtej, si dhe shfaqjet e islamofobisë në trojet shqiptare, si një dukuri që duhet trajtuar me kujdes dhe urtësi nga besimtarët dhe institucionet e tyre fetare.

## MYFTIU: “MOS E ULNI KOKËN, JETONI ME DINJITETIN E ISLAMIT!”

**D**itën e xhuma, më 31 janar 2014, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari mbajti hytben e radhës në xhaminë e re të lagjes Dërgut.

Në hytben e kësaj jave, Myftiu foli mbi dashurinë e sahabëve ndaj Pejgamberit (a.s), si një shtysë garante për të jetuar me dinjitet dhe krenari legjitime, si muslimanë të përkushtuar në jetë.

Gjatë ligjëratës, doli në pah sakrifica e madhe e sahabëve në rrugën e afrimit me të dërguarin dhe vullneti i tyre i pathyeshëm në drejtim të bindjes ndaj Zotit dhe mësimëve të Tij.

Në këtë hytbe, Myftiu dënoi politikën islamofobe në Kosovë dhe Shqipëri, që gjatë këtyre viteve po punon në dëm të interesave kombëtare, sidomos kur fjala është për raportet me fenë islame, fesë së pjesës dominuese të shqiptarëve në të gjitha trojet e tyre.

Myftiu përmendi mllfet e dëshmuara kohët e fundit, si projekt-ligji për ndalimin e ezanit nga 38 parlamentarët e Kosovës, si një lajthitje historike e pashembullt dhe e patolerueshme.

Në hytben e dytë të kësaj xhuma-je, Myftiu ka bërë homazh edhe për komandantin Hasan Riza Pasha, Mbrojtësin e Shkodrës, që me 30 janar 1913, u vra pabesisht në Shkodër. Ai udhëhoqi muslimanët e qytetit tonë në luftën kundra malazezëve, që e kishin rrethuar qytetin me qël-

Me rastin e kësaj vizite, Imam Muhamed Sytari ka shoqëruar Shaqir ef. Fetahun në një vizitë në dy medresetë e Shkodrës, ku janë pritur nga Drejtori, z. Kujtim Dervishi, i cili ka bërë një prezantim dinjitoz të arritjeve dhe realitetit të medresesë së Shkodrës, me dy degët e saj.



lime dashakeqe.

Myftiu ka theksuar se islamofobia e ka kapur për fyti qytetin e Shkodrës, sidomos në 24 vitet e fundit, fakt që vërtetohet me thjeshtësi, po të bëhet një vështrim në politikat e drejtimit të institucioneve kryesore vendore, vendet ku shpenzohen dhe orientohen donacionet për investime, emërtimet e institucioneve të ndryshme, shkollave, rrugëve etj.

Njëkohësisht ka kërkuar nga të pranishmit që të mos harrohet historia e nderit të këtij qyteti dhe të përmenden me vlerësim hoxhallarët e nderuar dhe shehlerët që drejtuan muslimanët e këtij qyteti, nën udhëheqjen e Komandant Hasan Riza Pashës, në luftën për mbrojtjen e Shkodrës, në ditët e para të pavarësisht të detyruar nga Perandoria më e fuqishme e shekujve të fundit, në momentet e degradimit të saj. Me këtë rast është bërë homazh për hoxhallarët e nderuar H. Halil Gavoçi, H. Sulejman Gavoçi, Sheh Ali Kruja, H. Ibrahim Repishti etj.



## KËSHILLI I MYFTINISË SHKODËR DISKUTON RAPORTIN E VITIT 2013



**N**ë mbledhjen e radhës, atë të datës 31 janar 2014, Këshilli i Myftinisë Shkodër diskutoi raportin e vitit 2013, projektet e reja për vitin 2014, gjendjen ekonomike aktuale të Myftinisë Shkodër, raportin mbi gjendjen e Qendrës Tregtare Zdralej, ecurinë e xhamive në ndërtim, interesimin për xhami të reja etj.

Fillimisht Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari ka lexuar raportin e vitit 2013, ku kanë spikatur aktivitetet e shumta dhe të larmishme, nëpërmjet të cilave Myftinia Shkodër u përpoq që viti 2013 të jetë një vit i mbushur me gjallëri fetare, në drejtime të ndryshme.

Është vlerësuar edhe aktiviteti i deritanishëm në drejtim të ndërtimit të xhamive të reja dhe nisja e punimeve për projekte të reja në shërbim të gjallërimit dhe pasurimit të jetës fetare të besimtarëve të Shkodrës. Njëkohësisht është vlerësuar edhe aktiviteti botues dhe bashkëpunimi me median vizive, elektronike dhe

atë të shkruar, që ka pasqyruar këtë aktivitet, gjatë gjithë vitit që shkoi.

Këshilltarët kanë diskutuar rreth këtij raporti dhe kanë dhënë mendimet e tyre dhe atë çfarë duhet përfutuar nga viti që shkoi, si dhe përmirësimet që duhen bërë në rrugën e forcimit të aktivitetit dhe Thirrjes Islame në krejt zonën.

Në këtë mbledhje është diskutuar edhe për projektet e reja në drejtim të ndërtimeve, ku është përmendur xhamia e re në fshatin Domën, xhamia e re në lagjen Dudas, Qendra e re Islame në lagjen Dudas, xhamia e re në zonën e ish-Zukthave etj.

Të pranishmit kanë dëgjuar edhe raportin e menaxherit të pronave, z. Blendi Alushi, mbi ecurinë e deritanishme të Qendrës Tregtare në lagjen Zdralej, marrëdhënien me klientët etj.



## MYFTIU PRITI KRYETARIN E SHOQATËS "ISTANBUL"

**D**itën e mërkurë, më 5 shkurt 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka pritur në një takim pune Kryetarin e Shoqatës "Istanbul", z. Ridvan Seferaj.

Gjatë takimit, është folur rreth bashkëpunimit të deritanishëm në mes të dy institucioneve dhe thellimit të tij, në drejtim të rritjes dhe forcimit të paraqitjes së Thirrjes Islame në Shkodër dhe në krejt zonën.

Myftiu ka falënderuar kontributet e deritanishme të Shoqatës "Istanbul", ku ka vlerësuar bashkëpunimin me Myftininë e Shkodrës në disa projekte dhe mbështetjen serioze të Me-



dresesë "Haxhi Sheh Shamia", me dy degët e saj.

Edhe Kryetari i "Istanbul", ka falënderuar bashkëpunimin e deritanishëm të Myftinisë Shkodër dhe ka garantuar se ky mirëkuptim dhe bashkëpunim do të vazhdojë edhe me projekte të tjera të përbashkëta, në shërbim të qëllimeve të dobishme.

Dy bashkëbiseduesit kanë diskutuar edhe rreth Qendrës Islame në Perash, e cila pritet të hapë dyert e saj në shërbim të interesave të përbashkëta të Myftinisë Shkodër dhe Shoqatës "Istanbul".



## GJURMA JOTE MBAN ERË MYSHKU, RRUGËVE ME JASEMINË...

I.

Hoxhë, Ti shkove... Gjurmën Tënde, as heshtja nuk e fshehu dot, s'e harron dhembja e ndarjes... Drita e buzëqeshjes Tënde, gjithandej në hapësirat e Damaskut gjallëron, si torçë udhëzimi drejt shpirtit të Dijes e Urtësisë... Hoxhë, Ti shkove. Le mall, kujtime burrash shekullorë, pas të cilëve dija të lidhi, si trashëgimtarë nderi, që motit nder i dhanë... Gjurma Jote, sokakut me hapa dhikri, ende mban erë myshku, rrugëve me jaseminë...

II.

Hoxhë, e lumtur dita fatlume e takimit tonë... Atë ditë, Drita e prezencës Tënde mbi Shkodër, si re madhështore, mbarte mall gjyshërisht me tepih të gjatë, hoxhallarësh me mjekra të thinjura e çallma me tarbush të kuq, e herë të zi... Atë Ditë fatlume, drita Jote, mbante era Hafiz Ali e Haxhi Muhamed, sillte mall Jusuf Efendi e Haxhi Sulejman, mbi tokë Shkodre me shpirt besimi, si minare

të bardha-udhëzim... Atë Ditë, ditë-lindja ime qe shënuar para Duarve Tuaja, Hoxhë...

III.

Si gjethe vjeshte, njëra pas tjetrës, vitet me Prezencën Tënde shkuan e, vjeshtë kujtimesh rrethon këtë botë pa Ty, kujtimi Yt... Si margaritar thesare, në thellësi të detrave të dijës, shkëlqen Nuri i Dorës Tënde, Hoxhë... Dorë Lapsi, që dritë dije kudo ka lënë, si amanet udhëzimi drejt Derës së Hakut, Hoxhë, me besë virdeh pa fund, në prag agimesh me frymë dhikri... Si gjethe stine gri, njëra pas tjetre, shkuan ditët e bardha, me feksimin e mjekrës Tënde, ngjyrë Dije e Urtësi...

IV.

Hoxhë... Malli, tingulli i fjalës Tënde, kujtimet e nostalgjia, në zemër, të gjallë mbajnë buzëqeshjen Tënde, si përherë, ulur në kolltukun Tënd besnik... Thonë se rënkon i gjori, si trung hurme ndër shekuj... Të kërkon, këdo pyet për ty e, kujtdo i lutet, një

lutje për ty, atje përtej, në botën e së Vërtetës së Pritur... Era Jote, Hoxhë, akoma ndjehet në këto anë... Ngado, në gjurmë librash, minaret e bardha, ende luten për ty; falemninderit të thonë... Ngado gjurma Jote, Hoxhë...

V.

Nuk e di, a të kam falënderuar ndonjë ditë, Sejjidi...? A të kam thënë më fal ndonjëherë...? A të kam thënë sa fatlume dita, në të cilën qe shënuar afrimi im në botën Tënde, si fëmija pranë derës së dijës e urtësisë...? Ah, Hoxhë, si shkuan vitet e mjekra Jote mbeti e bardhë, si bardhësi kujtimesh, që përherë jetojnë në pranverë malli për Ty, Hoxhë, i Miri Shejkh Vehbi... - Më fal, Zotëria im, që s'isha atë ditë kur u largove, më fal...! Dhe..., Faleminderit që ishe, sa herë të kërkova, për të më nxjerrë nga hija në dritë, nga errësira në udhëzim... Faleminderit Hoxhë..!


**Muhamed Sytari**

NJË VIT PA HOXHËN TONË, H. VEHBI S. GAVOÇI...



**“Ngushëllojmë ymetin islam për ndërrimin jetë të dijetarit  
Shejkh Vehbi Sulejman Gavoçi Shqiptari Damaskeni Hanefiu...  
Një ndër dijetarët më të shquar që jetuan në Damask.  
Prej mirësisë së tij ishte edhe kujdestaria ndaj një numri të madh  
të studentëve të dijes islame, sidomos të atyre nga Shqipëria  
që studiuuan në Fondacionin “Shejkh Ahmed Keftaro”  
dhe në Fondacionin “El-Fet’hul-Islami”**

*Dr. Salahudin Keftaro, Damask, Siri*



*“Me zemra të dorëzuar para përcaktimit të All-llahut,  
morëm lajmin e ndërrimit jetë të vëllait tonë fisnik fakihut, thirrësit,  
edukatorit Shejkh Vehbi Gavoçi Shqiptari...  
Ai është një nga dijetarët e mëdhenj të botës islame...  
Hirësia e Tij dijetari Vehbi Gavoçi Shqiptari  
ishte një argument në dije dhe njohuri, një nga dijetarët hyjnorë...  
Ai është autor i veprave të shumta të dobishme,  
në dy gjuhët, arabe dhe shqipe.  
I shërbeu dijes, fikhut dhe Thirrjes islame  
që në emigrimin e tij me familjen e tij, qëkur ishte 14 vjeç...  
Ymeti ka humbur një nga dijetarët e tij hyjnor (rabbani)...”*

**Dr. Jusuf El-Karadavi, Doha, Katar**



Hfz. Mehas Alija

Imam në xhaminë "El-Hidaje", Zvicër

Falënderimet dhe lëvdatat më të mëdha janë për Allahun e Madhëruar, Zotin dhe Krijuesin e të gjitha botëve. Selami dhe përshëndetjet tona qofshin edhe për të Dërguarin e Allahut, Muhammedin Alejhisselam, mbi familjen e tij të madhe, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që jetuan me të vërtetën në zemër.

**“O ju që besuat, as pasuria juaj e as fëmijët tuaj të mos u shmangin prej adhurimit të All-llahut, e kush bën ashtu të tillët janë mu ata të humburit.”** (Munafikun, 9).

Të dashur xhemat, hytben e sodit do ta fillojë me një hadith të Muhammedit a.s., në të cilin pasqyrohet një dialog midis shokëve të tij dhe Pejgamberit. Njëherë, Muhammedi a.s., i pyeti shokët e vet, radiallahu anhum: “Cila krijesë ju impresionon më së shumti me besimin e vet? Ashabët thanë: Me-

laqet. Pejgamberi a.s., u tha: E si të mos besonin ato, kur ato qëndrojnë pranë Zotit. Shokët, atëherë, thanë: Po, pejgamberët. Pejgamberi a.s., tha: E si të mos besonin ata, kur atyre u vjen shpallja. Shokët thanë: Po atëherë jemi vetë ne. Pejgamberi ynë i dashur, u tha: E si të mos besoni ju, kur unë jam midis jush. Më pastaj, i Dërguari i Allahut, s.a.v.s., tha: **“Unë, me të vërtetë, me shumë e admirojë besimin e atyre që do të vijnë pas meje, do t’i gjejnë fletët në të cilat është shkruar Libri, (pra Kur’ani dhe Sunneti), dhe fortë do të besojnë në të.”**

Vëllezër të mi të dashur, na ajetin e lartë cituar, Allahu xh.sh. urdhëron e thotë: **“O ju që besuat, as pasuria juaj e as fëmijët tuaj të mos u shmangin prej adhurimit të All-llahut, e kush bën ashtu të tillët janë mu ata të humburit.”** Nëse ne do të ishim nga ajo kategori të cilën e admiroi Pejgamberi a.s., atëherë këtë ajet duhet ta marrim me shumë seriozitet dhe ta besojmë fortë.

Po vallë, çfarë na mëson ajeti në fjalë? Nëse do t’i marrim gjërat me radhë se si thuhet në ajet, ku Zoti së pari e ka përmendur pasurinë dhe pastaj fëmijët, ndërkohë që asgjë në Kur’an nuk është e rastësishme, atëherë kuptojmë se njeriu më shumë e do pasurinë se sa fëmijët. Këtë e vërteton edhe realiteti ynë, kur shohim çdo ditë e më shumë, se si

## PASURIA D NË PESHOR

prindërit për shkak të pasurisë i mbysin fëmijët e tyre, ose fëmijët i mbysin prindërit. Në shoqërinë bashkëkohore rastet e këtilla janë me bollëk.

Besimtarët duhet të jenë të kujdesshëm dhe nuk duhet të lejojnë që pasuria dhe fëmijët të jenë preokupimi kryesor në jetë, dhe të harrojnë çdo përgjegjësi tjetër. Është e pa-



tolerueshme që për shkak të këtyre të lihet namazi, agjërimi, edukimi, shoqëria, farefisi, xhamia, etj. Ata që jepen pas pasurisë dhe pas fëmijëve dhe harrojnë përgjegjësinë që kanë për t’i rritur ata në frymën e besimit të shëndosh në Allahun xh.sh., pikërisht ata nesër, në Ditën e gjykimit, do të ballafaqohet me situata të palakmueshme. Atë ditë të ndihmon vetëm puna dhe produkti yt i mirë.

Allahu i Madhërishëm në suren Shuara, ajeti 88-89, thotë: **“Ditën kur nuk bën dobi as malli, as fëmijët. (bën dobi) Vetëm kush i paraqitet Zo-**

# HE FËMIJËT REN E FESË

**tit me zemër të shëndoshë.”**

Të dashur xhemat, sa ne tregojmë kujdes ndaj fëmijëve tanë, si e edukojmë, dhe në ç'drejtim i kemi orientuar ata, dhe a i kemi kryer të gjitha haket ndaj tyre?

A i dimë fjalët e Muhammedi a.s., ku thotë: *“Të gjithë ju jeni barinj, dhe secili prej jush do të përgjigjet*



*për kopenë e vet. Njeriu është bari në familjen e tij, dhe do të jap llogari për kopenë e vet.”*

Dijetari i shquar, El-Esh'ariu, ka thënë: *“Armiku yt nuk është ai që ti e mbyt në luftë apo ai që ty të mbyt, ti biesh shehid dhe fiton Xhennetin. Armiku i vërtetë është fëmija jot, i cili është prej shpinës tënde, dhe nuk e ke edukuar me mësimet e Fesë islame.”*

Vëllezër e motra, tani çështja ngel te vet ne, do të përgatisim gjenerata që do të na zbardhin fytyrën dhe fatin tonë, apo se do të bëjmë armiq,

që do t'ua shohim sherrin në këtë botë dhe në botën tjetër. Sa më afër Zotit të jemi, aq më pranë do t'i kemi edhe fëmijët.

Shumë njerëz duan që fëmijët e tyre t'i kenë të udhëzuar dhe në rrugë të mbarë, mirëpo ja që nuk kanë mundësi t'i kontrollojnë dhe të ndikojnë tek ta. Për një gjendje të tillë ndikojnë shumë faktorë, por ne do të mjaftoheni duke i përmendur vetëm dy:

- **i pari**, nuk kemi ndikim tek fëmijët për shkakun se i kemi lënë të lirë, nën tundimin e erërave të rrezikshme të kohës dhe të modës bashkëkohore, dhe

- **dy**, shumë prindër mundohen që fëmijëve t'ju mbjellin të njëjtën bindje dhe terbiye të tyre, madje edhe me dhunë, ndërkohë harrojnë se udhëzimi vjen vetëm nga Allahu i Madhërishëm. Shpesh harrojnë dhe nuk mendojnë rreth rastit të djalit të Nuhut a.s., dhe të babait të Ibrahimit a.s., të cilët vdiqën si pabesimtarë.

E vetmja gjë që mund ta forcojë fatin e fëmijëve tanë për në drejtimin e duhur, është lutja dhe lidhja jonë e fortë me Allahun xh.sh.

Për ta përmbyllë këtë hytbe, do të mjaftohemi me shembullin e një prindi, i cili, vërtetë, i do dhe i ndihmon fëmijët e tij. Ky ka qenë Ebu Esed Ed-Dueliu. Ai, një ditë, fëmijëve të vet, u tha: *“Fëmijë të mi, kam qenë i mirë*

*ndaj jush para se ju të lindnit, do të jem i mirë me ju edhe duke qenë gjallë, por do të jem i mirë edhe pasi të vdes, inshallah.”*

Fëmijët, të habitur e pyetën babain e tyre: *“E kemi të qartë ndihmën tënde që kur kemi lindur. Por nuk e kemi të qartë se si na ke ndihmuar para se të ishim lindur dhe se si ke për të na ndihmuar pasi që të vdesësh? Ba-*

*bai u përgjigj: “Para lindjes suaj, ua zgjodha nënën me të cilën ju nuk do të turpëroheni të dilni në rrugë, kurse pas vdekjes do t'ju ndihmoj me frikën dhe besimin tim që kam ndaj Allahut xh.sh. dhe me atë që, gjithmonë, kam folur me hak.”*

Vëllezër e motra të nderuara, ai i cili e ka prezent Allahun në jetën e tij dhe që mundohet, gjithmonë, të thotë hakun, le të mos frikësohet për sigurinë e fëmijëve të vet. Kështu e kanë komentuar, komentuesit e mëdhenj të Kur'anit, ajetin kuranor, ku Allahu xh.sh., thotë:

**“Le të frikësohen ata, sikur pas vetes të lënë fëmijë të dobët për të cilët kanë frikë se si do të jetë gjendja e tyre, pra le t'i ruhen Allahut dhe le të flasin gjithmonë fjalë të drejta.” (Nisa, 9).**

*(Hytbeja e xhumasë, mbajtur në xhaminë El-Hidaje në St. Gallen të Zvicrës, më 14.02.2014.)*

## MYFTIU, IMAMËVE: "ASNJË TOLERANCË PËRBALLË TENDENCAVE DENIGRUESE!"



**P**as drekën e së mërkurës, më 5 shkurt 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari ka mbledhur imamët e qytetit, në një takim pune mbi zhvillimet e fundit të tendencave islamofobike në trojet shqiptare, sprovat e shumta me të cilat përballen muslimanët në Shkodër dhe domosdoshërinë e angazhimit maksimal në shërbim të interesave të Thirrjes Islame.

Myftiu nuk ka lënë pa përmendur rastin e dëmtimit të shtatores së murgeshës Gonxhe Bojaxhi në Mitrovicë, që e ka konsideruar si tendencat përçarëse dhe përpjekjet për etiketimin e muslimanëve me diçka që nuk është as në natyrën as në genin e tyre, njëlloj si në rastin e kryqeve të sharruara në zonën e Shkodrës para disa vitesh a edhe vetë shtatoren e vendosur përballë xhamisë "Ebu Bekër".

Ka përmendur "këmbanën" e projektligjit që prek ezanin në Kosovë, si dhe ka porositur që askush nuk ka të drejtë të abuzojë me shenjtërinë e ezanit. Myftiu ka dhënë urdhër të prerë që askush përveç imamit dhe muezinit të xhamisë, nuk ka të drejtë të ndërhyjë në thirrjen e ezanit.

Në këtë kontekst, ai ka përmendur rastin e xhamisë "Ebu Bekër", ku mungesa e disiplinës së stafit të saj,

ka krijuar shpeshherë pakënaqësi në mesin e besimtarëve dhe qytetarëve të Shkodrës.

Myftiu është ndalur edhe tek disa problematika të tjera, me të cilat ndeshen sot muslimanët dhe besimtarët frekuentues brenda xhamive, ku ka theksuar se nuk do të tolerohet askush që do të dëshirojë të ndryshojë rregullin, traditën dhe disiplinën e xhamive tona.

Myftiu ka dëgjuar me vëmendje edhe diskutimet e imamëve, mendimet dhe idetë e tyre dhe është angazhuar se Myftinia Shkodër do të jetë e vëmendshme për të bërë punën e saj, duke respektuar këdo dhe duke mos toleruar asnjë përpjekje që sjell denigrim të muslimanëve, nga kushdo qoftë ajo.

### MYFTIU TAKON PREFEKTIN E SHKODRËS PËR XHAMINË E PLUMBIT

**P**araditën e së enjtes, më 6 shkurt 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka zhvilluar një takim pune në zyrën e Prefektit të Shkodrës, z. Paulin Radovani.

Fillimisht, me rastin e kësaj vizite të parë zyrtare, Myftiu e ka uruar

Prefektin me rastin e emërimit të tij në këtë post, duke shprehur njëkohësisht vlerësimin e tij për bashkëpunimin e vazhdueshëm të institucionit të Myftinisë Shkodër me atë të Prefektit të Shkodrës, gjatë viteve të shkuara.

Nga ana e tij, Prefekti i Shkodrës ka shprehur vlerësimin e tij për rolin elitar që luan Myftinia Shkodër në kultivimin e kulturës së besimit dhe përkushtimit të individit në Shkodër dhe më tej. Ai ka vlerësuar gjithashtu kontributin e Myftinisë Shkodër në prezantimin e saj si një institucion me vlera, në kuadër të gjallërimit të jetës fetare në Shkodër dhe jo vetëm.

Në qendër të vëmendjes së këtij takimi ka qenë xhamia e Plumbit dhe nevoja e madhe që ka kjo xhami dhe zona përreth saj për ngritjen e argjinaturave mbrojtëse, sidomos në këtë periudhë të vështirë të vitit, ku reshjet e shiut dhe ujrat e zonës së Qafës, mblidhen në bazenin e xhamisë së Plumbit, duke e rrezikuar përmytjen e saj dhe njëkohësisht duke penguar hapjen e saj për kryerjen e obligimeve fetare.

Është diskutuar edhe për problematikën e pronave në kufijtë e prefekturës, ku Myftiu ka kërkuar mbështetjen e Prefektit Radovani për zgjidhjen e disa prej këtyre çështjeve, që nuk marrin zgjidhje prej dekadash.



## MYFTIU BËN THIRRJE PËR RUAJTJE TË DINJITETIT ISLAM PËRBALLË SFIDAVE TË ISLAMOFOBISË

**N**ë ligjëratën e kësaj jave para të pranishëmve të shumtë në xhaminë e Parrucës, në hytben e të xhumasë, më 7 shkurt 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka vijuar të flasë mbi realitetet e përditshme, me të cilat përballen muslimanët në Shkodër, Shqipëri e më tej në trojet shqiptare.

Në hytben e tij, Myftiu ka kërkuar që muslimanët nuk duhet të vazhdojnë të pranojnë dhe të tolerojnë të konsiderohen si minoranca të padobishme në këtë qytet, ku kontributet e tyre janë të njohura dhe evidente.

Ka bërë thirrje që muslimani të ruajë dinjitetin e tij dhe të kërkojë respektimin e të drejtave që ia garanton ligji, duke aspiruar në këtë mënyrë kapërcimin e mentaliteteve provinciale, që e kanë mbajtur peng zhvillimin e tërësishëm të Shkodrës dhe fanatizmin e dëshmuar në investimet e ndryshme që janë bërë nga politika fanatike e viteve dhe dekadave të fundit.

Myftiu ka përmendur se e gjithë kjo ndodh për shkak të hutimit të muslimanëve dhe mosangazhimit të tyre me atë që u takon të japin e të kontribuojnë, të marrin e të përfitojnë, nga zhvillimi dhe ndërtimi i qytetit.

Në hytben e kësaj xhumaje Myftiu

## Këshilli i Myftinisë Shkodër, vizitë pune në Bashkësinë Islame Ulqin

**P**araditën e së shtunës, më 8 shkurt 2014, Këshilli i Myftinisë Shkodër ka organizuar një vizitë pune në Bashkësinë Islame të Ulqinit, në Mal të Zi.

Në mikpritje të delegacionit nga Shkodra, Kryeimami (Myftiu) i Ulqinit, Mr. Ali Bardhi, pasi i ka uruar mirëseardhjen në Ulqin vëllezërve

ka përmendur edhe provokimet fetare, me të cilat janë përballur muslimanët e Shkodrës gjatë këtyre 23 viteve të fundit, ku i është referuar mbjelljes së shtatoreve dhe busteve me tendenca fetare, joislame, në lulishtat dhe zonat, ku banojnë muslimanët.

Njëkohësisht ka përmendur edhe abuzimin që bëhet me përmendjen e personaliteteve të krishtera, si simbole kombëtare të shqiptarëve, a personifikime të kombit shqiptar në botë. Këtu, Myftiu ka pyetur: "Po Shejkh Nasir Albani, Shejkh Shuajb Arnauti, Shejkh Vehbi Sulejmani, në botë arabe, a Imam Vehbi Ismaili në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por dhe nobelisti shqiptar Ferid Murati, përse nuk përmenden si personalitete mbarëbotërore, fama e të cilëve ka kaluar kufijtë e kontinenteve, si dijetarë të aftë, me prejardhje shqiptare?".

nga Shkodra, ka vënë theksin te domosdoshmëria e takimeve të tilla, që forcojnë edhe më shumë urat e bashkëpunimit dhe vëllazërisë islame në mesin e drejtuesve fetarë dhe besimtarëve muslimanë të zonave përkatëse. Ai ka theksuar se tashmë ka ardhur koha që në vazhden dhe traditën e bashkëpunimeve të dy myftinive, të realizohet marrëveshja e binjakëzimit, që është hedhur edhe më përpara në takimet dypalëshe.

Nga ana e tij, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari ka vlerësuar mikpritjen dhe ka theksuar se këto takime janë shenja të qarta të vullnetit të mirë për bashkëpunim në mes të dy institucioneve, si dhe një tregues i emëruesve të përbashkët, që na bashkojnë e forcojnë edhe më tepër, duke nisur nga gjuha e bukur shqipe, traditat e vjetra, origjina kombëtare etj, të cilat duhen thelluar mbi bazat e besimit dhe fesë islame.

Me rastin e kësaj vizite, janë këmbyer edhe dhuratat simbolike, nëpërmjet të cilave janë këmbyer simbolikat e rëndësishme islame të dy qyteteve; Xhamia e Plumbit dhe ajo e Detarëve.

Vizita ka vijuar edhe me faljen e namazit të mesditës në xhaminë e re dhe të bukur të "Detarëve", ku në shenjë respekti dhe nderimi, Kryeimami i Ulqinit ka ftuar Myftiun e Shkodrës, të drejtojë këtë namaz me xhemat. Ndërkohë, Mr. Ali Bardhi i ka njohur vizitorët me një historik të kësaj xhamie dhe simbolikën e saj në këtë pikë strategjike të qytetit të Ulqinit.

Më pas, për nder të Këshillit të Myftinisë Shkodër, u shtrua një drekë e ngrohtë vëllazërore.





Arben Halluni - teolog

**S**ipas mësimave islame çdo njeri lind me besim të pastër Islam. Kjo pastërti besimore e njeriut duhet të zhvillohet, të kultivohet dhe të prodhojë sa më shumë devotshmëri e nënshtrim të sinqertë ndaj Krijuesit të gjithësisë. Qëllimi i njeriut në këtë jetë të përkohshme është të besuarit në monoteizëm, të adhuroarit në një Zot të vetëm dhe stolisja me moral të lartë në mënyrë që njeriu të arrijë lumturinë e kësaj jete lëndore dhe suksesin e jetës tjetër të përtejme.

Një pakujdesi qoftë edhe e masës së vogël mund ta dobësojë besimin. Një dukuri e tillë realisht është e përhapur shumë në individë të ndryshëm dhe brenda shoqërive të larmishme.

Ndoshta nga dukuritë e dobësimit të besimit te njeriu është neglizhenca dhe përtesa që tregohet ndaj nënshtrimeve dhe adhurimeve.

Ndodh që disa njerëz kryejnë ritualet në një formë të shpejtë, sikur po u vihet dikush prapa, me lëvizje pa shpirt, pa sens e pa synim. Ndonjëherë njeriu shfaq edhe përtesë ndaj adhurimeve, sidomos kur bëhet fjalë për çështjen e haxhit si një nga shtyllat kryesore të islamit, për të cilin ka mundësi materiale e shëndetësore.

Ka individë që dukurinë e përtesës e shfaqin edhe në vonimin ose mospjesëmarrjen në namazet me xhemat, në namazin e xhumasë, ndonjëherë edhe për namazin e xhenazes e të tjera nga ibadetet apo adhurimet e rëndësishme. Mos harro se Allahu xh.sh i ka përshkruar munafikët (hipokritët) si njerëz dembela dhe neglizhues në çështjen e namazit. “Munafikët përpiqen të mashtrojnë Allahun (duke u paraqitur rrejshëm si besimtarë), por Allahu mbizotëron dinakërinë e tyre.

# BESIMI

## PËRBALLË REALITETEVE TË SOTME

Ata edhe kur falen, falen me përtaci dhe vetëm sa për t’u dukur te njerëzit dhe fare pak e përmendin Allahun” (En-Nisaë:142).

Nga dukuritë e dobësimit të besimit është edhe mosbindja e njeriut për detyrimet e caktuara. Mendoj se kjo vjen si pasojë e mospërqendrimit siç duhet gjatë namazit, gjatë leximit të Kur’anit famëlartë e lutjeve dhe mos përpjekja për të medituar e menduar në kuptimet e verseteve kuranore.

Ai me këtë gjendje të zyrtë nuk mundohet të ndikohet nga ajetet përgëzuese e qortuese e as nga ajetet urdhëruese dhe ndaluese të Allahut xh.sh. “A nuk e studiojnë me vëmendje Kur’anin? Por jo, ata janë zemra që kanë drynat e vet!” (Muhamed:24). Ndërsa një ajet tjetër kuranor thotë: “Ne krijuam shumë nga xhinët e njerëzit për xhehenem. Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillë janë ata të marrët” (El-A’rafë:179).

Gjithashtu nga shkaqet e dobësimit të besimit tek njeriu është indiferentizmi që shfaq ndaj shkeljeve të ndaluarave, nuk urdhëron të tjerët kah e dobishmja sikundër nuk i ndalon kah e keqja. Për këtë profeti Muhamed a.s. ka thënë: “Kush sheh prej jush ndonjë të keqe le ta ndërrojë me dorë, po nuk mundi le ta luftojë me gojë, po nuk mundi ta bëjë as atë le ta konsiderojë të keqe me zemër, por kjo është grada më e ulët e besimit”.

Natyrisht këto citate profetike japin mesazhe të qarta për besimtarin, i cili ka për detyrë ta luftojë të keqen me çdo mënyrë. Së pari të përdorë dorën, domethënë po të ketë fuqi ta ndalojë keqbërësin me dorën e tij, po nëse nuk arrihet kjo mundësi atëherë të mundohet ta ndalojë duke folur e këshilluar. Në këtë kategori hyn dhe luftimi me shkrim. Kur sheh se një krim, vepër imorale, trillim, shpifje, hipokrizi etj,

janë përhapur dhe je i zoti i pendës është detyrë që të luftohet me anë të artikujve dhe materialeve të ndryshme. Por kur nuk e bën as të parën e as të dytën, pra nuk e lufton të keqen me dorë e as me gojë, së paku duhet ta konsiderosh me zemër të ligë dhe ta mohosh, por shton i dërguari i Allahut xh.sh, se ai që e ka të tretën tregon se nuk e ka besimin të fortë.

Duke vazhduar më tej vërejmë se besimin e dobëson edhe koprracia. Në lidhje me këtë profeti Muhamed a.s ka thënë: “Është e pamundur që koprracia e besimi të jenë së bashku në zemrën e robit”. Sa herë dëgjojmë e shohim njerëz me potenciale të mëdha pasurie që kanë zëvendësuar bujarinë me koprracinë, dorëdhënien me dorështrënguarën?! Njerëz të tillë nuk tregojnë tjetër përveç dobësisë së besimit dhe me të drejtë Kur’ani famëlartë i quan koprracë: “Pse sikur ta kërkojë tërë atë dhe t’ju shtrëngojë, ju do të bëni koprraci dhe do të dalë në shesh ajo që keni në zemra” (Muhamed:37).

Po ashtu nga dukuritë më të përhapura të dobësimit të besimit te njeriu është të thojë se atë nuk e bën. Urdhëron të tjerët për vepra të mira dhe vetë nuk i bën. Një person i tillë që herë vishet politeist e herë gjoja “monoteist” është sikur ai qiriu që ndriçon atë që gjendet afër tij dhe njëkohësisht shuan veten e tij.

Ka disa njerëz që e preferojnë atë rol që bën qiriu, sidomos klerikët politeistë. Ata shpjegojnë se qiriu që digjet i ngjason flijimit shpirtëror. Për këtë dukuri Allahu xh.sh thotë në Kur’an: “O ju që besuat, pse po e thoni atë që nuk e punoni? Tek Allahu është shumë e urryer ta thoni atë që nuk e punoni!”. (Es-Saff:2,3).

Në kuadër të saj do të përmendi një hadith kudsî (fjalë e Allahut xh.sh e shprehur nga profeti Muhamed a.s.) që tërheq vëmendjen e atyre që bëjnë punë e vepra për të fituar nderimin e



simpatinë e njerëzve e jo të Krijuesit të universit. Ata harrojnë se Allahu xh.sh i di të gjitha veprat dhe qëllimet e tyre, e askush të mos mendojë se mund ta gënjejnë të vërtetën e cila pa dyshim është pasqyra e madhërisë së Allahut xh.sh.

Transmetohet nga Ebu Hurejre (r.a), i cili thotë: “Dëgjova të dërguarin e Allahut xh.sh duke thënë. “Prej njerëzve të parë kundra të cilëve do të shpallet dënimi në Ditën e Llogarisë do të jetë njeriu, i cili ka rënë shehid (dëshmor). Ai do të sillet dhe Allahu do t’ia bëjë të njohura të mirat e Tij, e ai do t’i pranojë ato. I Madhëruari do ti i thotë: Ç’ka bërë me to (mirësi)? Ai do të thojë: Luftova për hir Tënd derisa rashë shehid. Ai (Allahu) do t’i thojë: Ti gënjeve, ti luftove që të flitet për ty se ishte guximtar dhe ashtu ishte. Pastaj ai do të urdhërohet për t’u tërhequr zvarrë derisa të hidhet në zjarrin e xhehenemit.

Tjetri do të jetë njeriu i cili ka studiuar në lëmin fetar, ka mësuar të tjerët për Islamin dhe ka lexuar Kur’anin. Ai do t’i thotë: Studiova diturinë fetare dhe e mësova atë. Po ashtu lexova Kur’anin për hir tënd. Ai do t’i thotë: Ti gënjeve, ti e studiove diturinë fetare që të thuhet për ty: Ai është një njeri i mësuar. Ti e lexove Kur’anin që të thuhet për ty: Ai është lexues (recitues) i mirë. Pastaj ai do të urdhërohet për t’u tërhequr zvarrë derisa të hidhet në zjarrin e xhehenemit.

Tjetri do të jetë ai të cilin Allahu e ka bërë të pasur, duke i dhënë të gjitha nga llojet e pasurisë. Ai do të sillet dhe Allahu do t’ia bëjë të njohura të mirat e Tij, e ai do t’i pranojë ato. I madhëruari do të i thotë. Çka bërë me to (mirësi)? Ai do t’i përgjigjet: Nuk lashë rrugë pa shkelur që Ti dëshiron për të shpenzuar nga pasuria, e unë e shpenzova atë për hir Tënd. Allahu do t’i thojë: Ti gënjeve, ti e bërë atë që të thohej për ty: Ai është bujar (dorëdhënës) dhe ashtu ishte. Pastaj ai do të urdhërohet për t’u tërhequr zvarrë derisa të hidhet në zjarrin e xhehenemit”.

Besimin e dobëson edhe të angazhuarit në ekstrem pas lehatimeve mashtruese të jetës lëndore, preokupimi për të gjetur mënyrat e shpresës së zgjatjes së jetës dhe grumbullimit

të pasurisë, duke harruar të drejtat ndaj Allahut, të drejtat ndaj familjes dhe të drejtat ndaj të tjerëve. Për këtë lloj kategorie Kur’ani famëlartë thotë: “Lëri (Muhamed) ata, të hanë, të dëfrehen dhe t’i preokupojë shpresa (se do të jetojnë shumë), e më vonë do të kuptojnë” (E-Hixhr:3). Ndërsa Imam Aliu bin Ebi Talib (r.a) ka thënë: “Unë frikësohem për ju se do të ndiqni epshet materiale dhe do të preokupoheni që të gjeni shpresën për të jetuar shumë. Vijimi i epshit material do t’ju shmang nga e drejta. Ndërsa shpresa për të jetuar më gjatë do t’ju bëjë të harroni Ahiretin”.

Përveç saj në traditën islame është përmendur: “Katër cilësi që e bëjnë njeriun të jetë i palumtur janë: syri që nuk loton, ashpërsia e zemrës, shpresa për të jetuar sa më shumë dhe të kushtuarit në thelb botës së përkohshme”. Pa dyshim se shpresa për të jetuar gjatë lind përtacinë ndaj nënshtrimeve fetare dhe bëhet indiferente ndaj kryerjes së riteve të larmishme të besimit Islam, të cilat natyrisht janë edhe qëllimi i ekzistimit tonë në këtë botë. Allahu xh.sh thotë në Librin e Shenjtë: “...e zgjati koha dhe zemrat e tyre u shtangën...” (El-Hadid:16).

Përmbledhurazi besimin e dobëson edhe kundërshtimet ndaj urdhëresave të ndryshme hyjnore, pirja e alkoolit me të gjitha llojet e tij, imoraliteti, përgojimi, thashethemet, shpifjet etj.

Atëherë natyrisht lind pyetja: Cili është shërimi i dukurisë së dobësimit të besimit?

Mënyra e shërimit të dobësisë së besimit është nëpërmjet shtimit të vepave të mira e dobiprurëse. Besoj se kjo është mënyra më e përshtatshme. Pikërisht për këtë Ebu Bekri Es-Sidik ka lënë për ne një shëmbëlltyrë të madhe, pasi një herë profeti Muhamed a.s pyeti sababet e tij: “Kush prej jush është sot agjërueshëm? -Ebu Bekri tha: Unë. -Profeti Muhamed përsëri pyeti: Kush ka vizituar sot një të sëmurë? -Përsëri Ebu Bekri iu përgjigj: Unë. -Profeti Muhamed a.s tha: Ai që ka kryer këto dy vepra të mëdha ka hyrë në xhennet” (Transmeton Muslim). Kjo histori tregon se Ebu Bekri (r.a) ka qenë i kujdesshëm për të shfrytëzuar rastet e volitshme adhuruese dhe

besimore. Kur pyetjet e të dërguarit të Allahut a.s. erdhën të papritura dhe si rrufe u argumentua se ditët e Ebu Bekrit kanë qenë të mbushura me devocione.

Nga ana tjetër çdo mysliman duke u nisur nga shembujt e përmendur më lartë duhet të jetë i kujdesshëm në çështjen e veprave të mira si: të shpejtuarit pas tyre, mbështetur në fjalët e Allahut xh.sh: “Dhe shpejtoni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për një xhennet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit” (Ali Imran:133).

Po ashtu duhet nga myslimani që të kryejë vazhdimisht nënshtrimet ndaj Krijuesit të gjithësisë dhe veprave të mira për hir të Tij. Ky parim është shumë i rëndësishëm në forcimin e besimit dhe ruajtjes nga dembelizmi.

Në këtë kuadër vlen të theksohet se e pakta e përhershme në adhurime është më e mirë se e shumta që ndërpritet. Një logjikë e tillë buron pa dyshim nga thëniet profetike të Muhamedit a.s, i cili pasi është pyetur një herë nga një prej sahabëve (shokëve të tij) se cilat janë veprat më të dashura tek Allahu është përgjigjur: “Veprat e vazhdueshme (të përhershme) edhe nëse janë të pakta” (Transmeton Buhariu).

Ajo çka e ndihmon gjithashtu myslimanin për shërimin e dukurisë së dobësimit të besimit është përpjekja sa të ketë mundësi nga ana e tij të njohë parimet e shariatit të tij, shtyllat e fesë, çka është pas vdekjes, çështjet e Mahsherit (Tubimit të madh në ditën e Kijametit), të mirat e xhennetit, ndëshkimet e zjarrit të xhehenemit, urtësinë e shariatit (legjislacionit Islam) në vendimet e hallallit dhe të harmit e të tjera çështje që kanë ardhur në shariatin e pastër dhe tolerant.

Nëse koha aktuale është e mbushur me dobësimin e besimit në disa individë të veçantë dhe shoqëri specifike për shkaqet e lartpërmendura, shërimi i sigurt është pa mëdyshje kthimi drejt lidhjes së fortë e të palëkundshme me fenë dhe të shtrënguarit fort pas qëllimeve të saj, të punuarit me Librin e Allahut (Kur’anin famëlartë) dhe me sunetin e profetit Muhamed a.s.

## INSPEKTOHEN DY XHAMI TË REJA NË NDËRTIM, NË DUDAS DHE TE ISH-ZUKTHAT



**N**ë kuadër të angazhimeve të Myftinisë Shkodër për rindërtimin e xhamive të reja, në vend të atyre që u prishën dhe u shkatërruan në vitin e errët 1967, ka nisur puna për ndërtimin e dy xhamive të reja në qytetin e Shkodrës, fillimisht xhamia te ish-Zukthat dhe ajo e Dudasit.

Ditën e sotme, të hënën, më 10 shkurt 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka inspektuar në terren gjendjen e punimeve për dy xhamitë e reja, të cilat do të plotësojnë akoma më shumë hartën e xhamive të qytetit, në vendet, ku ishin ndërtuar më parë.

Fillimisht, Myftiu është ndalur në lagjen Dudas, ku pas disa ditësh do të organizohet ceremonia zyrtare për fillimin e punimeve për ndërtimin e xhamisë së re të lagjes Dudas, si pjesë e bashkëpunimit të Myftini-

së Shkodër me Fondacionin “Mirësia”.

Më pas, në shoqëri edhe të menaxherit të pronave të Myftinisë Shkodër, z. Blendi Alushi dhe imamit, z. Ilir Dizdari, Myftiu ka inspektuar nga afër punimet për ndërtimin e xhamisë së re në zonën e ish-Zukthave (dikur xhamia e Shaban efendisë). Kjo xhami e re, me një projekt shumëfunksional, është pjesë e bashkëpunimit të Myftinisë Shkodër me AIITC, që afro një donacion nga Kuvajti për ngritjen e këtij kompleksi islam, i përfunduar më parë në qytetin e Shkodrës.

Myftinia Shkodër po interesohet dhe po lobon maksimalisht që të realizojë edhe ngritjen e katër xhamive të tjera në lagjet muslimane të qytetit, të cilat do të plotësojnë normalisht nevojat e besimtarëve për kryerjen e namazeve ditore.



"Ai që mësohet  
me tesbih (dhikër)  
para gjumit,  
do t'i jepet gjallëri  
dhe forcë në kryerjen  
e nevojave të tij,  
si dhe forcë  
në kryerjen  
e adhurimeve"

*Ibn Tejmije*

## Myftiu inspekton punimet për xhaminë e re në Trush

**P**araditën e së enjtes, më 13 shkurt 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka inspektuar në terren, gjendjen aktuale të punimeve në bijim për ndërtimin e xhamisë së re në fshatin Trush.

Në shoqëri edhe të imamet të xhamisë, H. Jetmir Braqi dhe menaxherit të pronave, z. Blendi Alushi, Myftiu ka ndjekur nga afër gjendjen e punimeve. Myftiu ka shprehur entuziazmin e tij dhe gëzimin e madh, që këtij fshati besimtar po i shtohet kjo xhami e dritshme dhe e bukur, mëse e nevojshme për kryerjen e adhurimeve dhe mësimit fetar.

Myftiu ka vlerësuar njëkohësisht punën e mjeshtrove nga Turqia, që kanë kontribuar për zbulimin e këtij fshati dhe krejt zonës me një xhami të arkitekturës osmane, ndër më të bukurat dhe më të spikaturat e arkitekturës botërore islame.



*E pyetën Sulejman Daraniun:  
Cila është puna me të cilën njeriu  
afrohet më së shumti tek All-llahu?  
Ai qau dhe tha:  
"Të vështrojë All-llahu në zemrën tënde  
dhe të gjejë se ti nuk e do këtë botë,  
as ahiretin, veçse për Të!"*

## MYFTIU PRITI DREJTORIN E FONDACIONIT "MIRËSIA"



**D**itën e enjte, më 13 shkurt 2014, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari, ka pritur në një takim të përzemërt pune, Drejtorin e Fondacionit "Mirësia", në Tiranë, z. Korab Kaja.


Në qendër të këtij takimi kanë qenë bashkëpunimet e frutshme, që Myftinia Shkodër ka me Fondacionin "Mirësia", sidomos në fushën e ndërtimit të disa xhamive të reja në Shkodër.

Myftiu ka falënderuar angazhimet e dobishme të Fondacionit "Mirësia", sidomos në drejtim të pasurimit të hartës së përhapjes së qendrave islame në Shqipëri, me xhami të reja, me një arkitekturë të përshtatshme për vendin dhe traditat e tij. Njëkohësisht, ka falënderuar mbështetjen që Fondacioni i ka dhënë Myftinisë

Shkodër në drejtim të angazhimit për ngritjen e dy xhamive të reja, në fshatin Domën dhe në lagjen Dudas, ku punimet vijojnë në mënyrë sistematike prej disa muajsh.

Nga ana e tij, edhe Drejtori i Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, ka falënderuar Myftiun e Shkodrës për bashkëpunimin dhe transparencën e treguar në drejtim të bashkëpunimit në kuadër të ngritjes së xhamive të reja, sidomos pas eksperiencës shumë të mirë me xhaminë e re që u ngrit në fshatin Kuç.

Ai ka konfirmuar se projektet e nisura, do të vazhdojnë sipas marrëveshjes dhe se ai dhe fondacioni që drejton, do të shqyrtojnë edhe disa kërkesa të tjera të Myftinisë Shkodër në rrugën e forcimit të bashkëpunimeve të përbashkëta.



Botues:  
Myftinia Shkodër  
Drejtues:  
Imam Muhamed Sytari

Dizajn & Grafik:  
Bledar Xama

Tel / Fax:  
+355 (0) 224 2081  
Nr. llogarie:  
100054 UBA - Shkodër

E-mail:  
udhaislame@myftinia-shkoder.org  
Website:  
www.myftinia-shkoder.org